

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Hartim projekti për Godinat Arsimore në Njësitë Administrative”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): [71221000-3 - Shërbim për projektim ndertesash](#)

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,151,533 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë.

Afati i shërbimeve do të jetë për një periudhë 62 ditë.

Në zbatim të urdhrimit të grupit të specifikimeve Nr.558 Datë 07.11.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike i pasi u njoh me objektin e prokurimit, programoi punën për përlllogaritjen e vlerës së projektit dhe hartimit të specifikimeve teknike duke u mbështetur në keto dokumenta:

- Vendimi vkm nr.354, datë. 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.
- Urdhërit Nr.5 të Agjencisë datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores për formatin e auditimit energjitik dhe pagesa për audituesin energjitik.
- Investime të kryera nga Bashkia në objekte të ngjashme.
- Buxhetin e Bashkisë Durrës.
- Vendim nr. 319, datë 12.4.2017 për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave dhe standardet e projektimit të shkollave.

PERLLOGARITJA E VLERES LIMIT TE KONTRATES

Per perlllogaritjen e vleres limit te kontrates, Mbeshtetur ne Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose me shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si per shëmbull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj): ose/dhe:

- a) Çmimet e tregut; ose/dhe.
- b) Çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore:ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Për llogaritjen e vlerës së projektit grupi i punës, sic edhe është theksuar më lart është mbështetur në Vendimin vkm 354 dt. 11.05.2016, dhe në punime të ngjashme. Si punime te ngjashme të cilat ne zgjodhem jane:

- Ndërtimi i shkollës “Shkolla në Fshat Rinia”
- Ndërtimi i shkollës “Artanzeka”

Llogaritja e vlerës së projektit duke u mbështetur në investimet e sipërpëmendura.

- Llogaritja e vlerës që do të duhet për ndërtimin e shkollave (kostoja e llogaritëshme),

1	SHKOLLA "FSHATI RINIA"	SIP (m2)	VLERA E INVESTIMIT (LEKE PA TVSH	KOSTOJA LLOGARITËSE (LEKE PA TVSH
	OBJEKTI	2013	62,883,168	31,238

2	SHKOLLA "ARTAN ZEKA"	SIP (m2)	VLERA E INVESTIMIT (LEKE PA TVSH	KOSTOJA LLOGARITËSE (LEKE PA TVSH
	OBJEKTI	1815	56,082,730	30,899

Kostoja mesatare e investimeve të Bashkisë për dy objektet që morëm si shembuj del si më poshtë:

			KOSTO MESATARE (leke/m2 PA TVSH)
	OBJEKTI		31,069




Figura 1 Vendodhja e shkollave 9 – vjeçare “Nënë Tereza & Vasil Ziu”

Shkollat Nënë Tereza dhe Vasil Ziu ndodhen në kryqëzim të rrugës “Aleksandër Goga” dhe “Aleks Komneni”, Njësia Administrative Nr. 2, Durrës.

Shkolla Vasil Ziu ka një sipërfaqe totale e pronës 2080 m2, ku sipërfaqja aktuale e ndërtimit është 930 m2.

Shkolla Nën Tereza ka një sipërfaqe totale e pronës 2428 m², ku sipërfaqja aktuale e ndërtimit është 380 m².

Shkolla Met Hasa ka një sipërfaqe totale e pronës 650 m², ku sipërfaqja aktuale e ndërtimit është 280 m².

Me përllogaritjen paraprake bashkimi i dy shkollave do të ketë afërsisht 1200 nx po te llogarisesh 6m²/nx dalin 7200 m².

Shkolla Met Hasa përllogarite te jetë me 250 nxenes dhe 50 fëmijë, duke shkuar në total 300nx lpo të logarisesh 6m²/nx dalin 1800 m² ndërtim.

Duke shumëzuar sipërfaqen totale të shkollave që do të projektohen e cila është 9000m² me koston mesatare të nxjerrë nga rikonstruksionet e kryera që është 31.069 lekë/m², kostoja e llogaritshme e investimit që duhet të bëjë Bashkia për të realizuar këtë projekt është **279,621,000 lekë pa tvsh**, sipas tabelës së mëposhtme:

- Mbështetur në Vendimi K.M. 354, dt. 11.05.2016, kreu 3, Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre ref, nenit 24, 25 , grupi IV tarifor dhe në Tabelën 6: Tabela shoqëruese e tarifave, Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre, vlera **279,621,000** lekë nuk gjendet në tabelë, kështu që do të bëjmë interpolimin midis dy vlerave 210.000.000 dhe 280,000,000 lekë.
- Sipas tabelës nr 6 për Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre referuar, nenit 25 për vlerat 210,000,000 lekë dhe grup tarifor II, koficientët janë 2.56% - 3.09%.
Sipas tabelës nr 6 për Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre referuar, nenit 25 për vlerat 280,000,000 lekë dhe grup tarifor II, koficientët janë 2.51% - 3.03%.

Duke bërë interpolimin midis këtyre vlerave na dalin koficientët, minimalë 2.51 %dhe maksimalë 3.03%

Do të vazhdojmë llogaritjet për të përcaktuar vlerën minimale dhe maksimale të projektit.

Llogaritja e vlerës minimale të projektit.

- Kostoja e llogaritshme për ndërtimin e shkollave të reja mbas përllogaritjes sonë del **279,621,000** pa tvsh.
- Koficienti minimal sipas vkm nr.354 datë 11.05.2016 është **2.51 %**
- Vlera minimale e plotë e projektit, për të 9 fazat (nga faza e parë deri në fazën e nëntë) sipas sipas tabelës nr.5 “Tabela shoqëruese e tarifave neni 24” është

279,621,000 x 2.51 %= 7.018,487 lekë.

Llogaritja e vlerës maksimale të projektit.

- Kostoja e llogaritshme për rikonstrukcionin e shkollave mbas përlllogaritjes sonë del **279,621,000** lekë pa tvsh.
- Koficienti maksimal sipas vkm nr. 354 datë 11.05.2016 është 3.03%.
- Vlera maksimale e plotë e projektit, për të 9 fazat (nga faza e 1 deri në fazën e 9) sipas tabelës nr.5 “Tabela shoqëruese e tarifave neni 24”. është

279,621,000 x 3.03 %= 8.472,516 lekë.

Kërkesa jonë nga grupi projektimit do të jetë për përgatitjen e dokumentacionit nga faza I deri në fazën VII. Sipas përqindjes në tabelën nr.5 “Tabela shoqëruese e tarifave neni 24” Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre.

Nr.	Faza e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I	Analiza e detyrës së projektimit /përcaktimi i bazës së projektit	3% për ndërtesat 3% për ndarjet funksionale
2	Faza e II	Projektideja paraprake	7% për ndërtesat 7% për ndarjet funksionale
3	Faza e III	Projektideja përfundimtare	11% për ndërtesat 14% për ndarjet funksionale
4	Faza e IV	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	6% për ndërtesat 2% për ndarjet funksionale
5	Faza e V	Projekti i zbatimit	32% për ndërtesat 30% për ndarjet funksionale
6	Faza e VI	Preventivi përfundimtar	10% për ndërtesat 7% për ndarjet funksionale
7	Faza e VII	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	3% për ndërtesat 3% për ndarjet funksionale
8	Faza e VIII	Mbikëqyrja	25% për ndërtesat 31% për ndarjet funksionale
9	Faza e IX	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim	3% për ndërtesat 3% për ndarjet funksionale

Tabela 5: Tabela shoqëruese e tarifave, neni 24 – Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre.

Hartimi dokumentacionit teknik do të bëhet për vetem fazat, 2, 5, 6 që janë 49 % e vlerës së të gjithë fazave.

- **Vlera minimale** e dokumentacionit teknik për fazat 1-7 është :

7.018,487 lekë lekë x 49% = 3,439,059 lekë pa tvsh.

- **Vlera maksimale** e dokumentacionit teknik për fazat 1-7 është

8.472,516 lekë lekë x 49% = 4,151,533 lekë pa tvsh.

Mbështetur në llogaritë e mësipërme vlera e **“HARTIM PROJেকTI PER GODINA ARSIMORE”** është **4,151,533** lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e references) dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5 ;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1'600'000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe mbeshtetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të*

pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1’600’000 lekë,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse:

2.Projektues arkitekt:

b-1.objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2.qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulturi; objekte arsimore; 3.Objekte spitalore; terminallet në infrastrukture; vepra arti në infrastrukture.

d-Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe

3. Projektues konstruktor (strukturist):

a-Objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

d-Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej betonarmeje, muraturë dhe metalike.

4. Projektues instalator:

a-Projektim te instalimeve hidro-termosanitare

b-Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve të prodhimit të energjisë termike të burimeve të rinovueshme.

c-Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

f-Projektim te sistemeve kundra zjarrit.

g-Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.

h-Projektim te impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.)

j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit për objektet civile e industriale.

8. Projektues Gjeodet

a- Rivetime inxhinierike.

9. Studim Gjeologo-Inxhinierik - Hidrogjeologjik

a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

12. Studime të Sizmologjisë Inxhinierike.

a- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore

Argumetimi.

Licensa Projektues Arkitekt kërkohet për arsye se ai do të hartojë projektin për shkollat e reja që do të ndërtohen. Arkitekti projektues duhet të analizojë situatën urbane dhe duhet të bëjë zgjidhjen më të mirë për të realizuar një objekt cilësorë e dinitor për zonën duke ofruar kushtet më të mira për nxënësit. Gjithashtu ai duhet të organozojë dhe projektojë gjithë hapësirën urbane që rrethon shkollën dhe që është brenda rrethimit/pronës së shkollës duke e kthyer atë në një hapësirë në funksion të komunitetit.

Licensa Projektues konstruktor kërkohet për arsyen se inxhinjeri konstruktor me profil strukturit do të hartojë projektin konstruktiv të godinës së shkollës. Do ta vlerësojë kapacitetin mbajtës të strukturës duke bërë zgjidhjen më të mirë.

Licensa Projektues instalator kërkohet për arsye se në këtë projekt kërkohet realizohen projektet e rrethit elektrik, projektet HVAC, projektet furnizimit me ujë dhe KUB dhe KUZ, projektet MNZ, projektet e impianteve ngritëse si ashensori, projektet e sistemeve CCTV dhe ACCESS CONTROL.

Licensa Projektues Gjeodet kërkohet për arsye se ai do të hartojë rilevimin topografik të pronës dhe situatës urbane ku do të zhvillohet projekti.

Licensa Projektues Studim Gjeologo-Inxhinierik - Hidrogjeologjik, kërkohet për arsye se ai do të bëjë shpimet gjeologjike të sheshit të ndërtimit dhe do të hartojë raportin gjeologjik inxhinierik dhe hidrogjeologjik.

Licensa Studime të Sizmologjisë Inxhinierike kërkohet për arsye se nga ing. sozmolog do të bwjw studimin sizmik të sheshit të ndërtimit dhe do të hartojë raportin sizmologjisë inxhinierike.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| • Arkitekt | 1 (nje) |
| • Inxhinier Ndërtimi Konstruktor (strukturist) | 1 (nje) |
| • Inxhinier Elektrik | 1 (nje) |
| • Inxhinier Hidroteknik | 1 (nje) |
| • Inxhinier Mekanik | 1 (nje) |
| • Inxhinier Elektronik | 1 (nje) |
| • Inxhinjer Gjeodet | 1 (nje) |
| • Inxhinjer Gjeolog | 1 (nje) |
| • Inxhinjer Sizmolog | 1 (nje) |

Argumetimi.

Personeli i mësipërme kërkohet në bazë të zëbërthimit të nevojave për hartimin e projektit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 9 persona** në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 të DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Detyra e projektimit & Termat e references dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë bashkëngjitur.

Specifikime teknike/termave të referencës/detyrës së projektimit, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al
Ueb-faqe	www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Shërbim konsulence”

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-49812-11-14-2022

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Hartim projekti për Godinat Arsimore në Njësitë Administrative”.

5. Fondi limit: 4,151,533 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 62 ditë.

7. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **25.11.2022** Ora: **10:00**

Vendi: mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit